



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 483 Prot

Vlorë, më 03 . 04 .2024

VENDIM

Nr. 5 , datë 26 . 03 .2024

PËR DHËNIEN E TITULLIT VENDOR “NDERI I QARKUT VLORË”
Z. AGO FAIK NEZHA

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 26.03.2024 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM – së Nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 23, datë 20.07.2017 “Për miratimin e rregullores mbi procedurat e dhënies së Titujve Vendorë të Nderit”, propozimit të Shoqatës Atdhetare Kulturore LABËRIA “Nder i Kombit”, Dega Vlorë si dhe Vendimit të Komisionit Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit në Këshillin e Qarkut Vlorë,

VENDOSI;

1. Dhënien e Titullit Vendor “Nderi i Qarkut Vlorë” Z. Ago Faik NEZHA me motivacion *“Për kontributin e shquar në promovimin, afirmimin dhe mbrojtjen e vlerave patriotike e kulturore mbarë kombëtare. Intelektual atdhetar i cili ka kontribuar në ruajtjen dhe pasurimin e historisë, traditave, zakoneve, kulturës dhe folklorit të trevës së Labërisë, por edhe si studiues shkencor, shkrimtar, gazetar e publicist, shembull dhe frymëzim për brezat e rinj”.*
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit në Këshillin e Qarkut Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ervis Mocka

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkrësë Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2024

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 603



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM - së Nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 23, datë 20.07.2017 “Për miratimin e Rregullores mbi procedurat e dhënies së “Titujve Vendorë të Nderit” si dhe Urdhërit të Titullarit Nr.25 (Nr. 282 Prot), datë 23.02.2024 “Për ngritjen e Komisionit Këshillimor për dhënien e Titujve Vendorë të Nderit në Këshillin e Qarkut Vlorë për vitin 2024”, pranë Këshillit të Qarkut Vlorë funksionon Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit me përbërje 2 (dy) personalite të jashtëm dhe 3 (tre) persona pjesë e administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë.

Në mbledhjen e tij të datës 08.03.2024 ky Komision ka shqyrtuar propozimin e bërë nga Shoqata Atdhetare Kulturore LABËRIA “Nder i Kombit”, Dega Vlorë, për akordimin e titullit “Nderi i Qarkut Vlorë” z. Ago Faik Nezha dhe doli me Vendim Nr.1 (Nr. 358 Prot), datë 08.03.2024 .

I propozuari z. Ago Faik Nezha ka lindur në fshatin Dukat të Rrethit të Vlorës, më 04.09.1945.

Është diplomuar në vitin 1971 në Institutin e Lartë Bujqësor, Fakulteti “Agronomi”. Në vitin 1990 është diplomuar në Universitetin Bujqësor, Fakulteti i Ekonomisë Agrare, dega Plan. Po kështu është diplomuar edhe në vitin 1976 në degën Filozofi.

Gjithashtu në vitin 1996 ka marrë gradën “Doktor i shkencave Ekonomike”, në 2001 titullin “Profesor i asocuar” si dhe në vitin 2009 titullin “Profesor Doktor”

Veprimtaria e tij pedagogjike është e hershme dhe nis qysh në vitet 1978 – 1980 si pedagog i jashtëm në lëndën e Filozofisë në Universitetin e Tiranës, në degët e Inxhinierisë Elektrike dhe Mekanike (natën) dhe Gjeologji – Miniera (ditën). Karriera e tij pedagogjike vazhdon në vitet 1980 – 2014 si pedagog i jashtëm (mësimdhënie) në Fakultetin e Ekonomisë Agrare, Universiteti Bujqësor i Tiranës. Nga vitet 1990 e në vazhdim ka dhënë e jep mësim në 6 (gjashtë) universitete private të Tiranës si : “Motrat

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” , Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 603



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Qirjazi”; “Akademia e Biznesit”; “Vitrina”; “Ndërkombëtare”; “Metropolitan” dhe aktualisht në Universitetin “Luarasi” ku ligjëron lëndët “Logjika” në Fakultetin e Drejtësisë; “Komunikim në Biznes” në Fakultetin Ekonomik; “Shkrim Akademik” në Fakultetin Ekonomik dhe atë të Mësuesisë; “Marrëdhënie me Publikun” në Fakultetin Ekonomik si dhe “Kërkim Shkencor” në Fakultetin Ekonomik (Master).

Veprimtaria e tij pedagogjike nuk konsiston vetëm si mësimdhënës, por edhe si Udhëheqës Disertacioni të dy disertantëve për titullin “Doktor Shkencash”; Udhëheqës i 35 (tridhjetë e pesë) temave shkencore – diploma studentësh; Udhëheqës i dy oponencave për mbrojtje të gradës “Doktor Shkencash” si dhe dhjetra recensa për mbrojtje temash dhe artikuj shkencor të botuara në buletine dhe revista shkencore; Anëtar Jurie në 4 (katër) mbrojtje për grada shkencore dhe 2 (dy) për titullin “Profesor i Asocuar”.

Janë të shumta botimet dhe punimet shkencore të Prof. Dr. Ago Nezhës ku mund të përmendim : 9 (nëntë) tituj në Monografi; 7 (shtatë) libra me përmbajtje profesionale; 9 (nëntë) tituj librash me karakter teknik dhe popullarizues të shkencës si dhe bashkautor në Enciklopedinë “Historia e Bujqësisë Shqiptare”.

Prof. Dr. Ago Nezhë njihet gjithashtu edhe për botime në fushën artistike, në prozë, poezi si dhe publicistikë ku përmendim : 5 (pesë) vëllime me poezi (“Lot në Sytë e Detit”; “Diell i Tradhëtuar”; “Hall me nuse, keq me vjehrra”; “Pse vrapoj” dhe Hënë e Verbuar); 8 (tetë) vëllime në prozë (“Lypsi dhe Zyrtari”; “Rron gjatë ai që lë emër të mirë”; “50 vjet të ndarë 50 vjet të bashkuar”; “Dialogoj me Diabolikët”; “Shtëpia në Amfiteatrin e Pemëve”; “Balil Nezhë Kalorës i Trimërisë”; “Portrete me Penë” si dhe “Sfidat e jetës të Seit Boshnjakut”); 6 (gjashtë) vëllime publicistike (“Papagajtë e Politikës”; “Ishim më mirë kur ishim më keq”; “Shoqata Atdhetare Kulturore Labëria 30 vjet jetë dhe Aktivitet”; “Shqipëria dhe Krahinomania”; “Demonët e Demokracisë” si dhe “Informacioni dhe komunikimi në Bujqësi”).

Ka realizuar 15 (pesëmbëdhjetë) tituj të dokumentarëve bujqësor të transmetuar në TVSH si dhe ka realizuar një film dokumentar artistik “Dukati, një vend magjik”.

Kanë qenë të shumtë artikujt në shtypin periodik ku përmendim rreth 36 (tridhjetë e gjashtë) artikuj shkencor të botuar brenda dhe jashtë vendit si dhe mbi 3000 (tre mijë) artikuj publicistikë të botuara në 55 (pesëdhjetë e pesë) organe të shtypit periodik si dhe në revista dhe gazeta para dhe pas viteve ’90 si dhe vazhdon të jetë aktiv me shkrime në gazetatat periodike. Gjithashtu ka mbajtur rreth 9 (nëntë) referate dhe kumtesa në Konferenca e Seminare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 603



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

Prof. Dr. Ago Nezha njihet për vlerat dhe aftësitë e tij drejtuese dhe si anëtar i forumeve kombëtare dhe ndërkombëtare ku përmendim rolet e tij si : sekretar i kolegjiut të “Buletinit të Shkencave Bujqësore”; drejtor i revistës “Bujqësia shqiptare”; kryetari i Këshillit Botues të gazetës “Progresi Agrar”; kryetari i Këshillit Botues të gazetës “Dukati”; kryetari i Këshillit Botues të gazetës “Labëria”; kryetar i Shoqatës të “Vlerësimit të tokës”; kryetar i Shoqatës Atdhetare Kulturore “Labëria” “Nder i Kombit” nga viti 2003 e në vazhdim; nën/kryetar i Shoqatës mbarëkombëtare Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni; krijues dhe kryetar i Shoqatës “Dukati”, dega Tiranë; anëtar i “Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë”; “anëtar i Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë (International Federation of Journalists) me qendër në Bruksel; anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve të Bujqësisë (International federation of Agrikultural Journalists); anëtar i Forumit “Polifonia Shqiptare”; drejtor i Informacionit të Këshillit të agrobiznesit Shqiptar; drejtor i Drejtorisë së Informacionit Agroushqimor si dhe kandidat i Byrosë së Komitetit Qëndror të Rinisë.

Ka qenë organizator dhe pjesëmarrës në shumë festa, konkurse dhe panaire kombëtare dhe ndërkombëtare ku përmendim në ato kombëtare : a. Festa e prodhimit (festa e Vreshtarëve në Vlorë dhe Shkodër; festa e Agrumeve në Sarandë, e bukës në Lushnje dhe Korçë; e mollëve dhe qershive në Dibër e Korçë si dhe e perimeve në Sukth – Durrës); b. Konkursat (konkursi i Kalit; Hipizmi dhe i Gjedit në Shkodër; i deleve në Korçë dhe Kukës; i dhisë në Tepelenë; i mekanikës në Lushnje dhe Tiranë si dhe i ullirit në Vlorë); c. Panairat (“Expo – Prima”; “Klik – Ekspo – Klik”; “Korça” si dhe “Panairi i Botimeve Bujqësore”. Në panairat ndërkombëtare përmendim : panairi “Java e Gjellbër”, Berlin – Gjermani; panairi “Polagra Food”, Poznan - Poloni; panairi “Fiera Del Levante”, Bari – Itali; panairi i “Mekanikës”, Monpelje – Francë; panairi Bujqësor, Selanik – Greqi; panairi Bujqësor, Madrid – Spanjë etj.

Prof. Dr. Ago Nezha është vlerësuar dhe ka marrë një numër të madh tituj nderi si : Urdhëri i Presidentit të Republikës “Mjeshtër i Madh” (Nr. Dekreti 7547, datë 22.06.2012); Urdhër i Presidentit të Republikës “Kallorës i Urdhërit të Skënderbeut” (Nr. Dekreti 9370, datë 18.12.2015); “Personalitet i Shquar i Labërisë” (vendim i forumit të SHKA “Labëria”, datë 29.01.2007); “Personalitet i Shquar i Qarkut të Vlorës (VKQ Nr. 26/2, datë 22.11.2012); “Nderi Qarkut Gjirokastrë”) Vendim Nr. 1, datë 20.05.2014); “Qytetar Nderi i Bashkisë Orikum” (Vendim Nr. 10, datë 07.05.2015); “Qytetar Nderi i Tepelenës” (vendim Nr. 35, datë 29.05.2020); “Qytetar Nderi i Vlorës” (Vendim Nr. 88, datë 16.12.2021); Medalje “Për shërbime të shquara shtetërore dhe shoqërore” (dekret Nr. 6085, datë 28.12.1979); Medalje e Punës (Dekret Nr. 4446, datë 10.10.1968);

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” , Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 603



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Mirënjohje e Shoqatës “Polifonia Shqiptare” (datë 30.04.2017); Diplomë nga “Shoqata e Gazetarëve të Bujqësisë” (datë 19.12.2009); Mirënjohje nga “Shoqata e Gazetarëve të Bujqësisë” (datë 20.20.2010); Mirënjohje nga “Kryegjyshata Botërore Bektashiane, Selia e Shenjtë” (datë 22.02.2016); Nderi i “Forumit të Mbrojtjes së Trashëgimisë Historiko – Kulturore Kombëtare” (datë 19.12.2021); Çertifikatë mirënjohje “Kryesia e fshatit Fterrë (datë 19.10.2022) si dhe Nder i Shoqatës Atdhetare Kulturore “Përmeti”.

Komisioni Këshillimor duke pasur nderin të shqyrtojë propozimin e bërë nga Shoqata Atdhetare Kulturore LABËRIA “Nder i Kombit”, propozon akordimin e titullit “Nderi i Qarkut Vlorë” me motivacionin ***“Për kontributin e shquar në promovimin, afirmimin dhe mbrojtjen e vlerave patriotike e kulturore mbarë kombëtare. Intelektual atdhetar i cili ka kontribuar në ruajtjen dhe pasurimin e historisë, traditave, zakoneve, kulturës dhe folklorit të trevës së Labërisë, por edhe si studiues shkencor, shkrimtar, gazetar e publicist, shembull dhe frymëzim për brezat e rinj”.***

Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit

Vllasi Nasaj

Alma Myrtaj

Blerina Lula